

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: " RIFORMIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E
DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS", DURRËS – FAZA I

OBJEKTI DHE VLERA PUNIMEVE–KUSHTET E VECANTA LIDHUR ME KONTRATEN DHE DETYRIMET E SIPERMARRESIT

OBJEKTI I PUNIMEVE

Objekti i punimeve, bazuar ne kontrate eshte ndertimi sipas ligjeve dhe specifikimeve teknike eshte: " Riprofilim dhe mbushje me rërë e vijës bregdetare nga Ura e Dajlanit deri tek godina e Kavalishencës", Durrës

FORMA DHE PERMASAT KRYESORE TE PUNIMEVE

Forma, permasat kryesore dhe karakteristika te tjera gjeometrike dhe fizike te punimeve, nxirren nga fletet e vizatimit te projektit, si dhe nga saktesimi me i mire i aktit te zbatimit nga Mbikqyresi (Drejtuesi) i Punimeve, bazuar ne grafiket e paraqitur nga Sipermarresi.

Sipermarrsi mund te prezantoje, pas miratimit nga ana e Punedhesisit, ato variante te dobishme per kryerjen e punimeve ne baze te konstatimeve dhe rezultateve te marra nga punimet e para te realizuara.

REFERENCAT PLANIMETRIKE DHE ALTIMETRIKE

Te gjitha punimet do t'i referohen Sistemi i Referimit KRRGJSH 2010, dhe per llogari te tij Firma zbatuese, do te marre dhe do te fiksoje nje sistem pikash referimi te percaktuar bashke me Drejtuesin e Punimeve; ky sistem pikash referimi do te realizohet gjate rilevimit, para fillimit te punimeve, ne baze te perpunimit te te dhenave te kryer nga sipermarresi dhe te miratuar nga Drejtuesi i Punimeve, ne afersi te punimeve dhe duhet te ruhet.

FILLIMI I PUNIMEVE

Per fillimin e punimeve, qofte edhe te pjesshem, do te pergatitet proces verbali.

Nga data e proces verbalit te dorezimit te fundit do te hyjne ne fuqi termat per kryerjen e punimeve sic eshte percaktuar ne kontrate

Pas marrjes ne dorezim te sheshit te punimeve do te behet percaktimi i shtrirjes se punimeve te ndryshme me referimet planimetrike dha altometrike te piketuara ne terren.

PROGRAMI I PUNIMEVE

Brenda 30 diteve nga marrja e punimeve ne dorezim, Sipermarresi duhet te paraqese prane Mbikqyresit (Drejtuesit) te Punimeve programin e zbatimit te punimeve.

Programi i lartepemendur i punimeve duhet te jete i detajuar dmth duke iu referuar punimeve qe do te kryhen do te percaktoje fillimin, ecurine mujore dhe afatin e perfundimit te kategorive kryesore te punimeve.

Punedhenesi nepermjet Mbikqyresit te Punimeve mund te kerkoje modifikimin e ketij programi edhe gjate zbatimit te punimeve, dhe ne kete rast Sipermarresi ka detyrimin te paraqese per aprovim prane Mbikqyresit te Punimeve programin e perditesuar.

ZBATIMI I PUNIMEVE

Punimet do te kryhen nga Sipermarresi ne perputhje me vizatimet e projektit te aprovuara nga Punedhenesi, me menyra dhe mjete te tilla qe te siguroje kryerjen e punimeve ne menyre profesionale dhe, duke zbatuar me perpikeri dispozitat ketyre specifikimeve dhe te dokumentave te permendur ne kete dokument.

PERSONELI I SIPERMARRESIT NE KANTIER. DISIPLINA NE KANTIERE

Sipermarresi duhet te siguroje qe per kryerjen e punimeve me efikasitet, te caktohet personeli i duhur teknik, me aftesi te provuara, dhe i pershtatshem nga ane numerike dhe kualitative per plotesimin e vevojave dhe permbushjen e detyrimeve te marra persiper me paraqitjen e programit te punimeve. Sipermarresi duhet te siguroje pranine e vazhdueshme dhe te perditeshme ne objekt te pergjegjesit teknik te kantierit.

Sipermarresi duhet te pergjigjet per pershtatshmerine e drejtuesve te kantierit dhe ne pergjithesi te gjithe personelit te punesuar ne objekt. Sidoqofte, ky personel duhet te kete pelqimin e Punedhenesit dhe te Mbikqyresit te Punimeve.

SHPRONESIMET, OKUPIMET E PERKOHESHME, VENDGRUMBULLIMET E HEDHURINAVE, RRUGET E SHERBIMIT DHE TE HYRJES NE KANTIERE, LEJET AUTORIZIMET PERKATESE

Sipermarresi do te promovojë, pas autorizimit nga Punedhenesi, praktikat per zenien (okupimin) e perhershëm ose te perkohshëm te zonave ku do te ngrihen punimet, me ane te procedurave te dhenies apo shpronesimit, duke bere parashikimin e shpenzimeve te lidhura me keto procedura, te cilat do te rimbursohen plotesisht nga Punedhenesi.

Nga ana tjetër, Sipermarresi do te siguroje, me kujdesin dhe shpenzimet e veta, autorizimet per okupimin e



hapesirave ujqore te nevojshme per realizimin e punimeve, si dhe per cdo rruge sherbimi e hyrjeje ne kantiere, per ngritjen e vete kantierëve, per depozitimin e materialeve te paperdorshem dhe per tere punimet e perkohshme ne pergjithesi, duke iu permbajtur rreptesisht te gjitha kerkesave dhe rregullave te caktuara nga Autoritetet dhe Administrata publike kompetente.

Punimet e perkoheshme (si psh kanale sherbimi, germime, zona te perkoheshme te grumbullimit te plerave, etj.) duhet te jene objekt i propozimit teknik qe duhet te miratohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

MIREMBAJTJA E PUNIMEVE

Derisa te mos jete bere kolaudimi i punimeve te permendura ne keto specifikime dhe rezultati te kete qene pozitiv, mirembajtja e ketyre punimeve duhet te kryhet nen kujdesin dhe me shpenzimet e Konkensionarit, pra te firmes zbatuese.

KOLAUDIMI DHE PAGESA PERFUNDIMTARE

Kolaudimi i punimeve ne fjale, do te behet nga Komisioni i Kolaudimit i emeruar per kete qellim. Bashke me kolaudimin do te percaktohen dhe zgjidhen edhe mosmarreveshjet e mundshme, me perjashtim te ceshtjeve gjyqesore per probleme te pazgjidhura.



CILESIA DHE ORIGJINA E MATERIALEVE

Te pergjithshme

Materiali i perdorur per mbushjen me rere duhet te jete rere e paster e aprovuar nga Mbikqyresi dhe Investitori . Rera nuk duhet te jete nga prodhimi i gureve me thyerje por duhet te jete me origjine detare . Rera duhet te jete e paster pa mbeturina ndertimi, asfalti, argjile dhe çdo material tjetër që nuk i perket kesaj kategorie

Madhesia mesatare e kokrrizave dhe uniformiteti

Madhesia mesatare e kokrrizave te reres (D50) duhet te jete me e madhe se 0.3 mm dhe me e vogel se 0.6 mm. Koeficienti i uniformitetit Cu sipas BS EN ISO 14688-2 nuk duhet te jete me i madhe se $2 \div 3$ ku:

$$CU = D60/D10$$

Materiali i imet

Jo me shume se 1 % e mases se thate duhet te jete material i imet me madhesi grimce jo më pak se sa 0,063 mm sipas BS EN 13139:2002.

Materiali i trashe

Materiali i trashe ose zhavorri me grimca $4.75 \div 19$ mm sipas ASTM 2487/2488 nuk duhet te jete me shume se sa 3%.

Përmbajtja organike

Materiali mbushes nuk duhet te jete me permbajtje organike .

Ngjyra

Materiali mbushes duhet te kete ngjyre te reres natyrale te plazhit .

Karriera e reres



Vendi për marrjen e reres për mbushjen e plazhit do të merret në një distancë prej 30 km rreth objektit .

Vendosja e reres

Vendosja e reres për mbushje do të bëhet në mënyrë të lirë pa ngjeshje dhe pa shkaktuar dëmtim të strukturave. Profili dhe pjerresia e vendosjes do të bëhet sipas vizatimeve përkatëse .

Testimet

Testet Laboratorike

Lista e testimeve do të bëhet sipas BS EN 1997-2:2007 si vijon:

- Shpërndarja granulometrike e grimcave
- Përbajtja organike
- Ngjyra .

Para-vendosjes në veper

Një kg mostër e rërë për çdo 5000 m³ rere të sjellur në objekt duhet të testohet në laborator në përputhje me BS EN 1997-2:2007. Rera që nuk plotëson kushtet e testit do të largohet nga objekti .

Pas vendosjes në veper

Pas vendosjes në veper Kontraktori duhet që të testojë kampionet e reres në mënyrë që ajo është sipas parametrave të projektit . Mostrat 1 kg do të mbledhen përgjatë seksioneve me interval çdo 40 m . Për çdo seksion do të merren 3 mostra në këto vende :

- 1) 1 Nr. 1 kg mostër nga plazhi në +0.35 m .
- 2) 1 Nr. 1 kg mostër nga niveli i ujit të detit +0.0 m .
- 3) 1 Nr. 1 kg mostër në pikën -1.00 m .

Të gjitha mostrat do të testohen në laborator në përputhje me BS EN 1997-2: 2007 dhe duhet të jenë brenda specifikimeve të projektit. Rera që nuk plotëson kushtet e testit do të largohet nga objekti.



Inspektimi

- Pas vendosjes se reres profili do te kontrollohet çdo 40 m dhe duhet te jene konform vizatimeve te projektit.

Tolerancat

- Toleranca horizontale: +200 mm; – 200 mm



SPECIFIKIMET PER MATERIALIN SHKEMBOR

CILËSIA E SHKËMBIT

Te pergjithshme

- I gjithë materiali shkembor duhet të jetë kompakt dhe pa çarje ose mikroçarje
- Materiali duhet të jetë brenda parametrave fiziko – mekanik të shkëmbit baze, nuk duhet të ketë gjurme të shperberjes kimike nga veprimi i ajrit, ujit dhe agjenteve të tjere atmosferik.
- Materiali i përdorur duhet të jetë i pastër nga papastërtitë si dhëra, lymra torfa material organik si dhe vrime të hapura për aqellime shperthimi .
- Materiali duhet të jetë rezistent në procesin e transportimit dhe vendosjes në veprë pa u demtuar ose krijuar çarje .
- Materiali shkembor i prodhuar në gurorë duhet të jetë vizualisht i pastër dhe nuk duhet të ketë papastërti kimike ose të trupave të huaja në sasi të tilla që këto të jenë të dëmshme për aplikimin konstruktiv të gurit ose për mjedisin në të cilin do të vendoset materiali.

Karriera për nxjerrjen e shkëmbit

- I gjithë materiali shkembor që do të përdoret do të jetë nga e njëjta karriera që të ofrojë një uniformitet të objektit të mbaruar si në cilësi ashtu dhe në ngjyrë dhe permase .
- Nuk duhet që të ketë perzierje të materialit të përdorur nga karriera të ndryshme. Nëq nuk arrihet që të përmbushen kërkesat për sasi të materialit nga e njëjta karriera, përdorimi i një karriera të re duhet të bëhet me aprovimin e Mbikqyresit të punimeve, por dhe materiali i ri duhet të njejat karakteristika si në cilësi, permase dhe ngjyrë me karrierën kryesore të aprovuar .

Kontrolli i cilësisë së karrierës

Në fillim të aprovimit të karrierës së propozuar nga Kontraktori, duhet që ai të parashtrijë procedurën e zgjedhjes së materialit cilësor për ndertimin e objektit. Kjo procedurë do të përfshijë, por pa u kufizuar në :

- Vlerësimet e mundshme gjeologjike gjatë fazës së nxjerrjes së materialit që ndikojnë në



cilesine e shkembit, tipit, perberjes mineralogjike dhe integritetit te tij .

- Aftesi ne perzgjedhjen e skemes se shperthimit e cila ul ne maksimum e nxjerrjen e materialit me carje te fshehura .
- Koha e magazinimit te shkembit te nxjerrur ne karriere .
- Proceduren e refuzimit të materialit te nxjerre ne karriere qe eshte jashtë madhësisë se projektit dhe ka te meta përpara dërgimit te tij ne kantier

Forma e materialit shkembor

- Mbulesa e Skolieres dhe mbushja e poshte saj nuk duhet të përmbajnë më shumë se sa 50% te numrit te gureve te perdorur me raport gjatesi/trashesi me te madh se sa 2 ku gjatesia eshte distanca me e gjate dhe trashesia distanca me e shkurter mes dy planeve paralele .
- Jo më shumë se sa 5% e të shkëmbinj te medhenj dhe jo më shumë se sa 20% e shkëmbinjeve qe do te raport gjatesi/trashesi me te madh se sa 3.

Karakteristikat e materialit shkembor

Duke testuar Kriteret	Kërkesat
Dendësia	Dendesia e materialit per perdorimin e veshjes se jashtme te skolieres do te jete jo me pak se 2600 kg/m ³ ne te pakten 90 % te materialit te perdorur dhe per pjesen tjeter dendesia duhet te jete jo me pak se 2550 kg/m ³ .
Ujethithja	Ujethithja do te jete jo më shumë se sa 2% për shkëmbinj e marra kampion ne baze te Seksionit 8.0 te standartit europian 13383-2.
Rezistenca ndaj agjenteve atmosferik	Sulfati i magnezit ne mostrat e testuar te jete në përputhje me BS 812 Pjesë 121 të jetë më pak se sa 18%. Standardet 13382-2.
Rezistenca ne shtypje	Forca e kerkuar per te prodhuar 10% material te imet do të jete jo më pak se sa 100 kN në përputhje me BS 812 Pjesë 111.
Integriteti i bllokut shkembor	Blloqet shkembore te prodhuara duhet te jene vizualisht pa çarje , vena , çarje te medha, shtresa shiste argjilor, shtresezime dhe te meta te tjera te cilat mund te cojne ne shkaterrimin e bllokut gjate transportit dhe vendosjes ne veper .



Rezistenca ne gerryerje	Humbja e materialit ne baze te testit Los Angeles ne perputhje me ASTM C-131 nuk duhet te kaloje 35 %
Rezistenca ne shtypje e shkembit	Forca njeaksiale ne shtypje (ISRM, 1988 ose ASTM D2398) duhet te jete jo më pak se sa 80 N/mm ²

Vendosja shtresave te poshtme te skolieres

Vendosja e shtresë e poshtme dhe pjeses qendrore te skolieres duhet te behet ne perputhje me kerkesat e meposhtme .

- Shtresa e poshtme dhe pjesa qendrore e skolieres duhet te vendosen ne menyre qe te arrihet nje shtrese kompakte, por pa perdorur ngjeshjen e tij .
- Shtresa e poshtme dhe bërthama do të vendosen me kujdes qe te shmanget dëmtimi i siperfaqeve te meposhtme si dhe e gjeotekstilit .
- Shtresa e poshtme dhe bërthama do te vendosen ne menyre te tille qe te behet nje shperndarje uniforme e shkembinve me dimensione te ndryshme duke evituar veperqendrimin e materialit me diameter te vogel ne nje vend .
- Vendosja e gureve do te jete e tille qe te arrihet stabiliteti i tyre vetem ne planin e ferkimit for te jene gjithashtu te inkastruar tek njeri tjetri .
- Hedhja nga lart e gureve mbi shtresen e gjeotekstilit nuk eshte e lejueshme .

Vendosja e Shtreses se jashtme te skolieres

Vendosja e shtreses se jashtme te skolieres duhet te behet ne baze te kushteve te meposhtme

- Guret duhet te vendosen individualisht ne menyre qe te arrihet nje shtrese kompakte dhe te inkastruar me guret e tjere .
- Vendosja e gureve do te behet duke filluar nga baza ne drejtim te kurores se skolieres
- Shkëmbinj do të jo të jetë vendosur ne menyre te tille qe te arrijne qendrueshmerine per efekt te ferkimit .
- Nuk lejohet hedhja e lire e gureve nga kamioni ose makineri te tjera .
- Vendosja e shkembit duhet te behet ne pergjithesi duke vendosur gjatesine e tij pingul me



pjerresine e skarpates . Trashesia e veshjes se jashtme duhet te jete e perbere nga dy rreshta guresh .

- Per mbylljen e hapsirave mes gureve per krijimin e profilit te skolieres nuk mund te perdoren gure te vegjel ose vendosje guresh te medhenj per hapsira me te vogla se 0.50*Dn50 .
- Mbikqyresi duhet te monitoroje ne vazhdimesi qe vendosja e gureve te behet minimumi ne tre pika mbeshtetje .
- Kontraktori duhet te largoje nga struktura cdo shkemb qe mund te gjendet i coptuar me carje mbas vendosjes ne veper .

Tolerancat

- Skoliera do të ndertohet sipas linjave te dhene ne vizatimet perkatese brenda tolerancave vertikale dhe horizontale te dhena ketu .

Toleranca per pjesen qendrore

- Toleranca vertikale per vendosjen e pjeses qendrore te shtreses se poshtme do të jetë ± 200 mm krahasuar me vizatimet e projektit.
- Matjet do të jene çdo 10 m intervale ne gjatesi dhe çdo 1 m ne lartesi .
-

Toleranca per veshjen e jashtme te skolieres

	Vlera
Materiali i vendosur mbi ujë	+0,35D n50
	-0,25D n50
Materiali i vendosur nen ujë	+0,6D n50
	-0.4D n50



SPECIFIKIMET PER GJEOTEKSTILIN

Vetitë

- Gjeotekstili qe do te perdoret si a filtër poshtë shkëmb nuk duhet te kete mateial pelhure dhe te jete prodhuar me kualitet te larte “virgin polypropylene” që përmban minimumi 1% ne peshë karbon aktiv te zi.
- Gjeotekstilet e prodhuara nga fibra te me shume se nje polimeri nuk jane te lejueshme

Vetit e gjeotekstilit jane si me poshte :

Vetite	Testet	Njesia	Vlerat	Toleranca e
Mechanical Properties				
Trashesia ne 2 kPa	EN ISO 9863-1: 2005	mm	≥ 6.7	n/a
Forca statike e shpimit (CBR)	EN ISO 12236	kN	≥ 11	-10%
Zhvendosja me shtytje	EN ISO 12236	mm	≥ 65	n/a
Rezistenca në tërheqje(MD/CMD)	EN ISO 10319	kN/m	≥ 60	-10%
Zgjatimi në tërheqje (MD/CMD)	EN ISO 10319	%	≥ 80	+/-30%
Diametri i vrimës së shpimit të pikës së konit	BS EN 13433	mm	≤ 1	+3 mm
Vetite filtruese				
prurja filtruese ne 50 mm presion	EN ISO 11058	l/s/m2	≥ 35	-30%
Koeficienti i Përshkueshmërisë (ks)	EN ISO 11058	m/s	≥ 4.7*10 ⁻	-30%
Madhesia e hapsires se vrimave, 90% (O90)	EN ISO 12956	µm	≤ 69	+/-30%
Kërkesat e qëndrueshmërisë (Sipas Aneksit B: EN13253)				
Rezistenca agjenteve (UV) ne 50 MJ/m2	EN 12224	Forca e ruajtur		> 80%
Ekspozimi rrezatues				
Rezistenca te Oksidimi (150 vjet)	EN 13438	Forca e ruajtur mbas 84 diteve		> 80%
Rezistenca Mikrobiologjike	EN 12225	Forca e ruajtur		> 80%
Rezistenca ndaj Lëngjeve	EN 14030	Forca e ruajtur		> 80%

RREGULAT E ZBATIMIT TE PUNIMEVE

Piketimi

Para fillimit te punimeve, Sipermarresi dhe Mbikqyresi i Punimeve do te kryejne se bashku verifikimin e profileve dhe te seksioneve te projektit dhe do te procedojne me zyrtarizimin e rilevimit te zonave ku do te realizohen punimet.

Pra, Sipermarresi duhet te ndjeke gjurmet e nevojshme dhe te siguroje paisjet dhe personelin e nevojshem.

Do te jene totalisht ne ngarkim te Sipermarresit, piketimet dhe ndryshimet per cdo variant qe mund te jete udhezuar nga Punedhenesi. Para verifikimit te rilevimeve te planit fillestar, Sipermarresi nuk duhet te beje asnje levizje te materialeve qe mund te ndryshojne gjendjen fillestare te terrenit.

Eshte e drejta e Mbikqyresit te kerkoje perseritjen e rilevimit nese gjykon se ka ndodhur ndonje ndryshim ne topografine e bregdetit per shkaqe natyrale (stuhi detare, transport te material, etj.)

Po te njejtat veprime duhet te kryhen (perseriten) ne rast te ndonje pezullimi te mundshem te parashikuar ne kete dokument.

Sinjalistika dhe germimi i skolieres

Sipermarresi eshte pergjegjes per te gjitha demet qe mund t'i shkaktohen strukturave ekzistuese ne det apo ne toke dhe ne pergjithesi cdo vepre nga perdorimi i mjeteve te papershtatshme dhe nga neglizhimi ne perdorimin e thelluesve te shtratit, rimorkiatureve, lundrave, mjeteve te transportit ne pergjithesi etj.

Gjithashtu Sipermarresi duhet t'i riparoje keto demtime apo te rimbursoje vleren e riparimeve nesa jane kryer nga Administratori i prones.

Sipermarresi, ne pergjegjesine e tij, duhet te kujdeset qe te zbatohen te tera masat paraprake per te shmangur demtimet e punimeve mbi dhe nen uje te cdo lloji, ne vecanti te kablllove elektrike, telefonike, tegrafike dhe tubacioneve te uje-sjellsave, gaz-sjellsave, impjantet e pastrimit te ujit, kanalizimet e ujrave te zeza, etj.

Objektet me vlere apo artistike te zbuluara gjate germimeve, do te jene prone e Shtetit.

Matjet e thellesise mund te kryhen si me ekograf ashtu edhe me thellesi-mates manual.

Punedhenesi nuk ka te drejte te ndryshoje piketimin edhe gjate zbatimit te punimeve, per sa i perket pjeseve te punimeve ende per t'u kryer; Sipermarresi nuk mund te kerkojne kompensim ne kete drejtim.

Hyrja dhe kalimi i mjeteve te punes – zona e kantierit

Hyrja per ne zonen e punimeve mund te lejohet vetem per mjete shume te nevojshme per kryerjen e tyre.

Sipermarresi, gjithashtu, duhet te sinjalizojë ndalimin e hyrjes ne zonat e punimeve per persona te pa angazhuar me punimet, per gjithe kohezgatjen e tyre.

Te gjitha detyrimet financiare per krijimin e rampave te sherbimit dhe/ose te hyrjes per ne zonat e punes, jane ne ngarkim te Sipermarresit, duke qene te perfshire ne cmimet njesi.

Gjithashtu jane ne ngarkim te Sipermarresit, detyrimet financiare per sistemimin e zones se kantierit dhe per realizimin apo sistemimin e pikave te ankorimit per ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve.

Germime te pergjitheshme

Germimet duhet te paraprihen nga largimi i pengesave te mundshme qe ekzistojne ne zonen e nderhyrjes si shtylla, gure. etj. Me pas mund te kryhen germimet deri ne kuotat e parashikuara nga projekti ose ato te udhezuara nga Mbikqyresi i Punimeve ne varesi te situatave qe mund te hasen gjate ecurise se punimeve. Sipermarresi duhet te siguroje materializimin ne vend te kuotes se nivelit mesatar te detit (n.m.d). Sigurimi i te gjitha lejeve te nevojshme per grumbullimin e mbetjeve do te behet nen kujdesin dhe me shpenzimet e Sipermarresit , keshtu qe Punedhenesi eshte i cliruar nga cdo pergjegjesi si ne lidhje me sigurimin e ketyre vendgrumbullimeve (ne toke apo ne det) ashtu edhe ne lidhje me menaxhimin e tyre.

Aty ku prania e sherbimeve te nendheshme e ben te detyrueshme, do te procedohet me germimin me dore deri ne zbulimin e plote te ketyre sherbimeve.

Nderhyrja ne sherbimet e nendheshme

Prania e sherbimeve te nendheshme duhet te percaktohet dhe raportohet nga ana e Sipermarresit, pasi te kete kontaktuar per kete ceshtje Subjektet pergjegjese.

Ky identifikim duhet te jete paraprak, me qellim qe te mundesoje keto Subjekte te hartojne nderhyrjet qe duhet te behen per te lejuar germimin e rradhes. Raporti me keto Subjekte eshte kompetence ekskluzive e sipermarresit i cili, duke marre parasysh nevojat lidhur me afatet e realizimit te punimeve dhe ne zbatim te udhezimeve perkatese nga ana e Mbikqyresit te Punimeve, duhet te marre keto iniciativa, qofte paraprake, per fillimin e punimeve, apo gjate zbatimit te tyre, te nevojshme per respektimin e programit te ecurise se punimeve.

Ne rastet kur prania e kanaleve kabllore dhe tubacioneve nuk lejon thellimin e germimit sipas parashikimit te projektit, keto duhet te largohen perkohesisht apo pergjithmone ne menyre qe here pas here te bihet dakort,

pas konsensusit te Mbikqyresit te Punimeve me Subjektet e interesuara.

Shpenzimet e bera dhe punimet e kryera me “dite pune”, do t’i njihen Sipermarresit vetem nese jane autorizuar nga Mbikqyresi i Punimeve.

Germime nenujore, vendgrumbullimet e plerave, sinjalistika

Germimet nenujore per realizimin e seksioneve te parashikuara nga projekti, mund te kryhen me cfaredo lloj mjeti te afte per te perftuar siluetat e parashikuara.

Ne kuoten e planit te germimit per t’u arritur, pranohet nje tolerance +/- 15 cm (pesembedhjete) nga kuota e fiksuar ne projekt. Germimi i kryer me thelle se kuota e fiksuar do te llogaritet brenda kufijve te tolerances se permendur, nderkohe qe nuk do te kete kompensim per germimet pertej kesaj tolerance.

Po njesoj, do te zbritet vellimi i germimit te kryer me pak, brenda tolerances prej 15 cm, nderkohe qe Sipermarresi duhet te kryeje thellimet e metejshme ne rast se hasen kuota germimi me te ulta se ato te projektuara te korrigjuara nga toleranca e lartpermendur. Pjerresia e skarpateve duhet te jete ajo e parashikuar ne projekt, pervec rasteve kur lloji i terrenit ose rrethana te tjera nuk imponojne pjerresi me te vogla. Materialet e marre nga germimet, ne varesi te natyres se tyre dhe sipas kerkesave te projektit do te transportohen:

- a) ne vendgrumbullimin e plerave ne det te hapur ne distance nga bregu, te percaktuar nga Autoritetet Detare;
- b) ne vendgrumbullimin e plerave ne toke ne zonat e parashikuara per grumbullimin e plerave publike;
- c) ne nje depozitim te perkohshem ne toke per munesi perdorimi te metejshem.

Demet e shkaktuar ne lundrimin ne lagune nuk mund te klasifikohen si ngjarje te forces madhore.

Ne lundrim dhe ne manovrat e ankorimit te anijeve, Sipermarresi edhte i detyruar te veproje ne perputhje me ligjet dhe rregulloret e policise se portit dhe lagunes dhe sipas dispozitave qe mund te jepen nga Autoritetet kompetente.

RREGULLAT PER MATJEN DHE VLERESIMIN E PUNIMEVE

Sasite e punimeve dhe te furnizimeve do te percaktohen me metoda gjeometrike me perjashtim te rasteve kur punimet paguhen me shuma fikse, ne baze te copeve, peshes apo kohes, ne perputhje me zerat e punes perkates te listes se cmimeve.

Disa punime mund te jene kryer me ekonomi (dite pune) ne baze te nje liste te vecante.

Rregulla e pergjithshme

Sasite e punimeve dhe te furnizimeve do te percaktohen me metoda gjeometrike me perjashtim te rasteve kur punimet paguhen me shuma fikse, ne baze te copeve, peshes apo kohes, ne perputhje me zerat e punes perkates te listes se cmimeve.

Gjeotekstili

Furnizimi dhe venia ne pune e filtrit sintetik do te vleresohet me m² te siperfaqes se aktualisht te mbuluar me mantel, duke konsideruar si te tille shumezimin e gjeresise komerciale me neton e mbivendosjes. Cmimi i listes perfshin dhe kompenson mbivendosjen ne nyje dhe/ose saldim te mundshem te tyre, operacionet e peshimit me elemente te pershtatshem ose, si alternative, fiksimin e telave ne shtratin e detit, detyrimet per asistencen e zhytesve apo gjithcka tjeter te nevojshem

Guret masive natyrore

Guret masive te te gjitha kategorive do te kompensohen ne meter kub: vellimi do te jete ne peshe, i percaktuar sipas

Cmimi i listes perfshin te gjitha detyrimet per furnizimin, venia ne pune me mjete detare dhe/apo tokesore, detyrimet per rregullimin e formes sipas udhezimeve te projektit edhe nese kjo do te sillte nevojten per te perzgjedhur guret me qellim plotesimin e boshlleqeve dhe te parregullsive.

Percaktimi i peshes dhe kategorise se gureve

Percaktimi i peshes dhe kategorise se gureve do te behet si vijon:

A) Numeracioni dhe kalibrimi i mjeteve te transportit

Arkat, karrocat, vagonet, kamionet dhe cdo lloj tjetër mjeti që do të shërbejë për transportin e gureve në rrugë tokësore, do të dallohen nga një numër rendor të cilit do t'i korrespondojë (tara) pesha pa ngarkesë e mjetit e përcaktuar nga peshimi i rregullt i tij dhe që duhet të paraqitet në një raport të vecantë.

Mbikqyesi i Punimeve mund të kërkojë gjithmone kontrollin e kalibrimit dhe njehsimit fillestar, dhe për çdo rast këto kontrole duhet të behen në intervale fikse prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh dhe për më tepër sa here që automjetet apo mjetet e lundrimit riparohen apo transformohen. Si kalibrimi edhe njehsimi fillestar ashtu edhe ato pasuese do të behen me shpenzimet e Sipermarresit dhe bashkëpunime me Mbikqyresin e Punimeve duke hartuar një raport të rregullt për çdo operacion.

Sipermarresi duhet të marrë të gjitha masat paraprake që vlejne për të garantuar rezultatin perfekt të punimeve duke iu përmbajtur edhe në këto fushe, të gjitha dispozitave të vendosura nga Mbikqyesi i Punimeve.

B) Peshimi i gureve dhe regjistrimi

Cdo mjet transporti duhet të mbartë, për çdo udhëtim, gure të vetëm një kategorie.

Pesha e gureve në përgjithësi duhet të përcaktohet me anë të përdorimit të peshorës (bilancia a bilico) ose, në rastet e transportit ujor, me anë të mjeteve lundruese me peshe të njehsuar siç përkruhet në paragrafin më lart.

Procesi i peshimit do të kryhet në bashkëpunim ndërmjet Mbikqyresit të Punimeve dhe Sipermarresit apo përfaqësuesve të tyre; këto pale do të firmosin faturën origjinale dhe një numër kopjesh sa të kërkohet nga Mbikqyesi i Punimeve.

1) Peshimi me bilico

Për procedurat e peshimit, Sipermarresi duhet të përdorë një ose më shumë peshore, duke patur në ngarkim çdo shpenzim dhe detyrim që rrjedh nga procedura e peshimit, përfshi këtu edhe instalimin e peshorës, kontrollin fillestar perkates dhe ato periodike nga ana e Zyres metrike kompetente për peshat dhe masat, riparimet e mundshme të peshorës dhe ndertimin e një kabanoni për përdorim nga personeli i Mbikqyresit të Punimeve i caktuar për procesin e peshimit.

Pesha e ngarkesave do të shprehet në ton dhe fraksione të tonit deri në shifren e tretë dhjetore; do të zbritet pesha pa ngarkesë e automjetit si dhe pesha e pykave apo kllapave të përdorur për fiksimin e gureve të

medhenj, duke perftuar keshtu peshen neto qe do te rregjistrohet ne librat e kontablit.

Sipermarresi duhet te siguroje blloqet e faturave; cdo fature duhet te kete daten dhe pervec peshes neto duhet te kete edhe peshen bruto, numrin rendor si dhe targen e automjetit apo te arkave te cilave i referohet fatura, si dhe kategorine e materialit te mbartur.

Cdo automjeti do t'i korespondoje nje grup faturash nga te cilat origjinali do te mbetet me Mbikqyresin e Punimeve qe kryen peshimin dhe kopjet ne pergjithesi do t'i dorezohen perfaqesuesit te Sipermarresit, drejtuesit te mjetit te transportit dhe personelit te Mbikqyresit te punimeve qe do te kryeje derdhjen e materialit ne veper.

Mbushje e plazhit me rere te importuar

Te gjitha aktivitetet e mbushjes te kompensuara me vellim, qe del nga niveli planit te pare dhe planit te dyte.

Seksionet, si te planit te pare ashtu edhe ne perfundim te procesit, do te rilevohen ne bashkepunim, me nje numer te mjaftueshem per paraqitjen e sakte te konfigurimit te terrenit dhe matjet e thellesise do te kryhen duke bere lexime te rumbullakosur me 5 cm referuar nivelit te detit.

Ne perfundim te punimeve segmentet e trajtuar do te kontrollohen perseri ne te njejtet progresive si gjate dorezimit dhe brenda 15 diteve nga perfundimi i punimi individual (germim apo mbushja)

Rilevimi (percaktimi i kuotave) si per planin e pare edhe per te dytin mund te kryhen, sipas rastit, me thellesi mates manual apo me ekograf. Ne rast te materialit mbushes, rilevimi i planit te dyte nuk mund te realizohet para 30 diteve nga data e mbushja.

Vellimi i mbushjes do te vleresohet duke matur me metoden e seksioneve te krahasuara. Sasite maksimale te materialit te germuar dhe/apo te importuar brenda tolerancave te caktuara ne Specifikime, do te llogariten me te njejtin cmim te germimit baze.

Toleranca e lejuar fiksohet +/- 10 cm per importet.

TAULANT sh.p.k & ABKONS sh.k

Perfaqesues me prokure

Ing. Ditika QATIPI

HARTOI

Dr. Andrin Kërpaçi